KQZ
U PROTOKOLLUA
Nr. 565 Prot.
Datë.më 28 2 2024

**E.S Financial Advisory shpk**
**Erjon Saraçi - AUDITUES LIGJOR**
**Licensa Nr.260, Date 27.08.2012**
**Adresa: Rruga Tefta Tashko Koço, Pall 132, Ap 1, Tirane**
**Mob. 0696002295**
**e-mail: erjons@gmail.com / officecloud.adv@gmail.com**

Tiranë, më 23.02.2024

**Lënda:** **Informacion në lidhje me mosrealizimin e shërbimit të auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore per zgjedhjet e organeve te qeverisjes vendore te dates 14 Maj 2023,si dhe per zgjedhjet e pjesshme vendore ne bashkine Kukes te dates 24 Shtator 2023 , Partia Uniteti Kombetar.**

**Për:** **Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve**
**Rruga "Ibrahim Rrugova", Nr. 4, Tiranë, Shqipëri**

Të nderuar zotërinj,

Me vendim nr.825, date 13.12.2023 të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve(KQZ) , datë 13.12.2023, jemi caktuar me cilësinë e ekspertit kontabël (audituesit ligjor) për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023 të subjektit zgjedhor "Partia Uniteti Kombetar".

Menjëherë pas lidhjes së kontratës me KQZ-në, ne kërkuam të vendosim komunikimin zyrtar me Partinë per Partia Uniteti Kombetarpër fillimin e proçedurave të auditimit, nëpërmjet dërgimit me poste të letres me kthim përgjigje, në adresën e selisë së partisë.

Sipas dokumentit bashkangjitur Z. Idajet Beqiri kryetari i partisë ka marre zarfin në të cilin është informuar në lidhje me kërkesën për fillimin e proçedurave të auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara të fushatës të datës 14 Maj 2023. (b/ngjitur)
Gjithashtu më datë 29.01.2024 është dërguar edhe një email në adresën zyrtare të partisë: Idajetbeqiri@hotmail.com në të cilën është komunikuar fillimi procedures se auditimit per subjektin qe drejton Z.Idajet Beqiri dhe nevojen për të na vënë në dispozicion informacionin për fillimin e auditimit (b/ngjitur)

Për këtë Parti u përdorën komunikimet që na u vunë në dispozicion nga KQZ si adresë selie, adresë emaili, informacione nga ekspertët paraardhës në misione të ngjashme, si edhe kërkime në internet, por të gjitha mënyrat e përdoruara nuk sollën rezultat.

Ne kërkuam edhe në faqen zyrtare të KQZ-së për raportimin financiar të fondeve të fushatës të datës 14 Maj 2023 të subjekteve zgjedhore por nuk gjetëm ndonjë raport financiar në lidhje me Partinë Uniteti Kombetar. (b/ngjitur)

Gjithashtu edhe nga raportet e monitorimit nuk rezultoi ndonjë gjetje.

Bashkangjitur dokumentacioni vërtetues:

- Letra e dërguar me postë bashke me konfirmimin e shërbimit postar per marrjen e shkreses për vënien në dijeni të proçesit të auditimit të fondeve të fushatës të datës 14 Maj 2023.
- E-maili i derguar ne adresën e partisë :ldajetbeqiri@hotmail.com
- Kerkimi ne faqen e KZQ per Raportim Financiar

Posta e derguar ne adresën e partisë: Kutia Postare 8288,Tirane rr.Nikolla Jorgo,pall shk 2 ap 3,tirane

Ju faleminderit për mirëkuptimin!

**E.S Financial Advisory shpk**

**Erjon Saraçi – AUDITUES LIGJOR**

E.S FINANCIAL ADVISORY
Sh.p.k.
NUIS : K 82230010 B
TIRANA - ALBANIA

E.S FINANCIAL ADVISORY
Sh.p.k.
NUIS : K 82230010 B
TIRANA - ALBANIA

**E.S Financial Advisory shpk**
**Erjon Saraçi – AUDITUES LIGJOR**
**Licensa Nr.260, Date 27.08.2012**
**Adresa: Rruga Tefta Tashko Koço, Pall 132, Ap 1, Tirane**
**Mob. 0696002295**
**e-mail: erjons@gmail.com / officecloud.adv@gmail.com**

---

Uniteti kombetar nuk eshte audituar.

Tiranë, më 26.01.2024

**Lënda: Kërkesë për fillimin e procedurave të auditimit ligjor**

**Për: Partia Uniteti Kombetar**
**Drejtuar kryetarit: Z. Idajet Beqiri**
**Adresa e selisë: Kutia Postare 8288,Tirane rr.Nikolla Jorgo,pall shk 2 ap 3,Tirane**

Sipas kontratës nr.221 prot. datë 23.01.2024 ,me palën angazhuese KQZ-në, objekti i misionit të auditimit eshtë: *"Kryerja e auditimit të detyrueshëm te partive politike të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore per organet e qeverisjes vendore te dates 14 maj 2023 ,si dhe per zgjedhjet e pjeshme vendore ne bashkine Kukes te dates 24 shtator 2023 në përputhje me ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar, aktet nënligjore të KQZ-së të miratuara për këtë qëllim, ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratur", i ndryshuar, dhe ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", si dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre"* dhe afati kufi i përfundimit të procesit te auditimit eshte data 23.02.2024

Për kryerjen me sukses të misionit, brenda kohës së përcaktuar në kontratë, ne presim bashkëpunim tuaj dhe të personelit që merret me shërbimin kontabël për të na berë të disponueshëm dokumentacionin kontabël,rregjistrimet dhe informacione të tjera që do të kërkohen në lidhje me auditimin tonë.

Ju lutem konfirmoni marrjen e kërkesës dhe na krijoni mundësinë e një takimi në selinë e partisë tuaj sa më shpejt të jetë e mundur, për të përcaktuar termat e angazhimit të auditimit.

Përgjigjen drejtojeni në adresën në krye të shkresës.

Faleminderit!

**E.S Financial Advisory shpk**
**Erjon Saraçi – AUDITUES LIGJOR**

E.S.FINANCIAL ADVISORY
Sh.p.k.
NUIS : K 82230010 B
TIRANA - ALBANIA

Zyra Postare ...
09-02-2024

| | |
|---|---|
| Nr: | 1001 |
| **DEFTESE** | 09/02/2024 10:57:22 |

**PRANIMI E OBJEKTEVE POSTARE**

| | | |
|---|---|---|
| Objekti | Letra | Leter |
| KOD-BAR | RR564407688AA | |
| Derguesi | ES FINANCIAL ADVISORY SHPK | |
| Marresi | PARTIA UNITETI KOMBETAR | |
| Vend Mberritja | TIRANA | |
| Pesha | 18 gr | |
| **Tarifa Totale** | | **70** |
| Nenshkrimi: | | Elleva Guzia |

Partia Uniteti Kombetar Inbox

**Audit & Advisory Office** <officecloud.adv@gmail.com>
to idajetbeqiri, Erjon

Mon, Jan 29, 10:30 AM

Pershendetje!
Zyra E.S. Financial Advisory sh.p.k me audituesi ligjor Erjon Saraçi eshte caktuar per auditimin e fondeve te perfituara dhe te shpenzuara per zgjedhjet per organet e qeverisjes vendore te dates 14 maj 2023 ne perputhje me ligjin nr.8580, date 17.02.2000, "Per partite Politike".

Presim pergatitjen e dokumentacionit te duhur per fillimin e ketij procesi.
Per cdo paqartesi ju lutem na kontaktoni ne cdo kohe.

--

Faleminderit

E.S Financial Advisory sh.p.k
officecloud.adv@gmail.com
Nr Zyra: 0673065058
Nr. Admin 0686002265

**Idajet Beqiri**
to me

Mon, Jan 29, 12:59 PM

Translate to English

Përshëndetje,
Faleminderit për komunikimin. Partia e Unitetit Kombëtar, të cilën unë drejtoj, nuk merr asnjëherë fonde nga buxheti i shtetit, nuk marrim as donacione e ndihma. Pra deklarohemi në çdo palë zgjedhje me bilancin zero. Gjithsesi jeni i mirëpritur për të kryer detyrën tuaj. Telefoni im është 0682002351, Respekte Idajet Beqiri

Dërguar nëpërmjet Galaxy

Raport financiar vjetor × 2023

× Partia Unitetit Kombetar ×

Aplikо filtrat

| Id | Emërtimi | Partia Politike | Viti | Veprimi |
|---|---|---|---|---|
| Nuk u gjet asnjë rekord. | | | | |